



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2483, datë 15.05.2014

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Plus Communication sh.a., ndaj Vendimeve të AKEP nr. 2431, nr. 2432, nr. 2433, nr. 2434 dhe 2435 të datës 13.3.2014, “Për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 15.05.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimi i ankimit administrativ të Plus Communication sh.a., ndaj Vendimeve të AKEP nr. 2431, nr. 2432, nr. 2433, nr. 2434 dhe 2435 të datës 13.3.2014, “Për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Plus Communication sh.a. me nr. 391Prot., datë 12.4.2014 (*nr. 1010Prot. i AKEP, datë 14.4.2014*) me anë të së cilës ka paraqitur ankim administrativ ndaj Vendimeve të AKEP, nr. 2431, nr. 2432, nr. 2433, nr. 2434 dhe 2435 të datës 13.3.2014, për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare sh.a.;
2. VKD nr. 2412, datë 16.1.2014 për “*Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”*”;
3. VKD nr. 2431 datë 13.3.2014 për “*Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për “Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”*”;
4. VKD nr.2432, datë 13.03.2014 për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a*”;
5. VKD nr. 2433 datë 13.3.2014, për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a.*”;
6. VKD nr.2434, datë 13.04.2014 për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albtelecom sh.a*”;
7. VKD nr.2435, datë 13.03.2014 për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Plus Communication sh.a*”;
8. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**),
si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Plus Communication sh.a. me anë të shkresës nr. 391Prot., datë 12.4.2014 ka paraqitur ankim administrativ ndaj Vendimeve të AKEP, përkatësisht:
 - VKD nr. 2431 datë 13.3.2014 për “*Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për “Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”*”;
 - VKD nr.2432, datë 13.03.2014 për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a*”;
 - VKD nr. 2433 datë 13.3.2014, për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a.*”;
 - VKD nr.2434, datë 13.04.2014 për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albtelecom sh.a*”;

- VKD nr.2435, datë 13.03.2014 për “Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Plus Communication sh.a.”;
2. Plus Communication sh.a. (Plus), e argumenton ankimin administrativ ndaj këtyre vendimeve, si më poshtë vijon:
- a. Plus kundërshton Vendimet e datës 13.3.2014 të AKEP si të pa drejta, të pa mbështetura në prova dhe në ligj e në dëm të interesave të ligjshme të Plus. Plus shpjegon se, bazuar në nenet 7, 8, 36, 53, 55 e 56 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, AKEP ka të drejtën dhe detyrimin për të rregulluar tarifat e komunikimeve elektronike. Por duke iu referuar vendimeve të mësipërme Plus shpjegon se, ato janë marrë nga AKEP mbi bazën e një Analizë të tregut celular të miratuar me Vendimin nr.2118, datë 4.07.2012. Ky dokument nuk përbën dokumentin e kërkuar nga ligji për marrjen e vendimeve për ndryshim tarifash në tregun me shumicë e nuk mundet objektivisht të pasqyrojë dhe në cdo rast nuk pasqyron kushtet aktuale të tregut të telefonisë celulare në Shqipëri (*dy vite më pas momentit të hartimit*). Nga ana tjetër ky fakt vërtetohet edhe nga vetë teksti i dokumentit pjesë integrale e Vendimit nr. 2431. Pra jo vetëm që AKEP ka kryer rishikimin e çmimeve të tregut të terminimit me shumicë pa asnjë analizë të tregut aktual por, parashikon po vetë se është e nevojshme marrja në konsideratë e kushteve aktuale dhe pritshmërive për zhvillim të tregut celular në Shqipëri. Plus shpjegon se nuk ka asnjë konsideratë ligjore apo faktike në asnjë prej vendimeve të ankimuara që justifikon në mënyrë të arsyeshme pritshmërinë e AKEP që pa kryer ende një analizë të tregut celular për vitet 2012 – 2013 të jetë e domosdoshme ndërhyrja në tregun në nivel shumice kur kjo ndërhyrje historikisht nuk ka prodhuar efektet e duhura në konkurrencën e lirë dhe efektive sidomos në tregun e pakicës. Në këto kushte, Plus konsideron se rishikimi/ndryshimi i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të operatorëve celularë, përfshirë ato të sipërmarrësit Plus, kryer me Vendimet e 13 Marsit 2014 nuk është bërë në përputhje me procedurën dhe parashikimet e parashikuara në nenet 36 e 56 të ligjit nr. 9918.
 - b. Nga ana tjetër, vetë Vendimi 2431 nuk parashikon apo indikon asjë të dhënë apo analizë që t’i referohet kushteve aktuale të tregut celular në Shqipëri e që janë marrë për bazë nga Grupi i punës në përlllogaritjen e dokumentacionit përkatës (*refuar pika 4 e Vendimit 2431, seksioni i titulluar ‘veren’*). Plus shprehet se sa kohë që këto kushte aktuale të tregut janë parashtruar si bazë për lëshimin e Vendimit 2431, është e domosdoshme minimalisht një parashtrim i tyre në dokument me qëllim, mundësimin e njohjes me këto të dhena nga operatorët e intersuar (*neni 108 i Kodit të Procedurave Administrative*) dhe konsultimin e tyre me palët e interesuara në përputhje me kërkesat e nenit 58 të Ligjit 9918.
 - c. Plus konstaton se Vendimet e ankimuara nuk reflektojnë as rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës të permendura në Vendimin 2431. Rishikimi i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të Plus dhe operatorëve të tjerë nuk është bërë në përputhje me rekomandimet e Vendimit nr 303 të Autoritetit të Konkurrencës, datë 16.1.2014, që vetë AKEP i referohet në Vendimin 2431. Sipas këtij

vendimi, të AK, “...AKEP duhet të marrë masa të ndërmjetme dhe të menjëhershme, për të bërë të zbatueshme zgjidhjet e rregullimit të tregut për të parandaluar daljet nga tregu të operatorëve të vegjël, që do të kishin pasoja të mëdha mbi konkurrencën...” Sipas Plus, AKEP nuk ka ndjekur rekomandimet e AK, por ka krijuar një model që është një transpozim e përsëritje identike e situatës aktuale të tregut shqipëtar pasi ai bazohet në reduktimin e tarifave pa garantuar uljen e tyre, jo në mbështetje të operatorëve të vegjël duke mos marrë parasysh pjesët përkatëse të tregut të cdo operatori duke e rënduar akoma më shumë pozitën e Plus ndaj atyre më të mëdhenj pasi i redukon menjëherë të ardhurat e tij duke ndikuar në mënyrë të pakthyeshme e negative në performancën ekonomike, teknike e financiare të këtij operatori.

d. Plus shprehet se, duke iu referuar Vendimeve të nkimuara, rezulton qartësisht se diferenca në vlerë absolute midis tarifave të terminimit të një operatori të vogël si Plus në raport me operatorët e tjerë është zvogëluar ndjeshëm nga 4.28 All që ishte kjo diferencë nga 1.9.2013 është zvogëluar përsëri në 3.86 AL me AMC/VF dhe 2.52 All me Eagle Mobile, duke shkaktuar një dëm ekonomik e me pasoja për Plus. E ndërsa na 1.09.2013 në 1.1.2016 të gjithë operatorëve të tjerë iu ulët tarifa me 3.09 All, për Plus ajo ulët 7.37 ALL, dmth 2.38 herë më shumë se të gjithë operatorët e tjerë brenda të njëjtës periudhë kur në realitet duhet të ndodhte e kundërta. Në vijim, Plus shpjegon se, duke iu referuar metodës së ndjekur për rregullimin e tarifave në nenin 57 të ligjit 9918, parashtrijmë se ndërsa Vendimi nr. 303 i AK, parashikon marrjen e masave për: a) uljen e ndjeshme të kostos së terminimit për operatorët e vegjël ndaj operatorëve të mëdhenj në këtë treg, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun përkatës; e b) detyrimin për zvogëlimin real të diferencës së tarifave off – net / on – net, brenda dhe jashtë paketave tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese, në fakt AKEP nuk i merr këto indikacione parasysh as për metodën e adoptuar për qëllim të rishikimit të tarifave në rrjetet celulare.

e. Plus, konsideron se:

- Ndodhur përpara paralajmërimeve tejet specifike nga AK me të cilin AKEP duhet të stabilizojë komunikim e bashkëpunum shumë të ngushtë me qëllim realizimin e detyrave të ngarkuara me ligj (neni 7.ç e 61 i ligjit 9918);
- Ndërsa nuk kishte mundur të kryente një analizë përditësuese të të dhënave që t'i mundësonin marrjen e një vendimi të mbështetur e të arsyetuar në fakte e ligj,

AKEP ka patur detyrimin që në respekt të neneve 9, 10, 11, 12, 13, 14, të K.Pr.A, të merrte parasysh kërkimet e neneve 57/2/ç, 57/2/c, të ligjit nr. 9918 i ndryshuar. Lidhur me këtë pikë Plus argumenton se, nivelet e tarifës së terminimit që propozon AKEP janë në bazë të një modeli benchmark (mesatare) sipas modelit LRIC i pastër, ku si referencë janë marrë vendet europiane të cilat karakterizohen si tregje të konsoliduar dhe vështirë se mund të gjenden në to tipare si ato të tregut shqiptar, si për nga përmasa në numër përdoruesish, ashtu edhe në aspektin demografik, në nivel të ardhurash, në nivel ekonomik, apo dhe në diversitetet në tregjet përkatëse.

- f. Plus shprehet se, AKEP ka detyrimin ligjor që në rastin konkret të marrë parasysh në vlerësimin e tij për tarifatat e terminimit analogjinë me vende të ngjashme me Shqipërinë dhe një model benchmarking ndërkombëtar do të ishte më i përshtatshëm për krahasim me shtete të cilat janë në kushte të njëjta me tregun Shqiptar. Nga ana tjetër, neni 57.3 i ligjit 9918 parashikon mundësinë e kombinimit të metodave për rregullimin e tarifave, duke i dhënë AKEP-it hapësirën maksimale të veprimit në të mirë të arritjes së objektivave të veta rregullatore në përputhje me ligjin.
- g. Po ashtu vendimet e ankimuarra janë edhe në mospërmbushje të detriminimit të AKEP për të siguruar mosdiskriminimin e barazi në trajtimin e operatoreve në tregun celular. Plus shprehet se, rishikimi i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të Plus, rezulton të jetë kryer në kundërshtim me nenin 7.1, 7.3, e 7/3.ç), e 7/3.ë) të ligjit 9918 pasi nuk siguron mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Nën këtë rregullim, Plus-it i imponohet pamundësia për të konkuruar në treg e praktikisht detyrohet të dalë nga tregu në një periudhë shumë të shkurtër duke bërë që situata e konkurrencës së tregut të kthehet “duopoly” e me efekte tepër negative për tregun shqiptar duke marrë parasysh konkurrencen dhe efektin tepër pozitiv në uljen e cmimeve për konsumatorin fundor që ka sjellë hyrja e Plus në treg. Nga eksperiencia e deritanishme e siç konfirmon dhe vendimi i AK nr. 303, Plus nuk ka mundur të hyjë në një konkurrencë të efektshme në tregun e telefonisë. Kështu ulja e menjëhershme e tarifave të terminimit për thirrjet në tregun me shumicë thellon favorizimin e operatorëve dominues në tarifatat me pakicë dhe zhbën mundësinë e investimeve efçente nga ky operator për ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme.
- h. Konsiderojmë si edhe në fazën e konsultimit publik se modeli i rregullimit sipas Vendimeve të kundërshtuara të AKEP është i parakohshëm dhe do të ishte i zbatueshëm në Shqipëri vetëm nëse do të kishim kushte të tjera trgu dhe pasi të merreshin një sërë masash për rregullimin e tregut të telefonisë së lëvizshme në Shqipëri. Plus thekson se vendimet e ankimuarra rezultojnë diskriminues e në dëm të Plus pasi ato bazohen në një përshkallëzim në ulje të tarifave në një periudhë kohore që nuk merr parasysh ndarjen e tregut përkatës të cdo operatori në treg si dhe respektimin e politikave të mëparshme për operatorë të ngjashëm me Plus në të kaluarën (Albtelecom/Eagle). Nëse AKEP do të arsyetojë në këtë rast se kushtet e tregut kanë ndryshuar ju lutemi referojuni po vendimit të AK 303. Në kushtet kur tregu ka problematika të theksuara për aspekte të konkurrencës dhe rezulton që të ketë operatorë me pozicion dominant, (shiko vendimin 303 të AK) konsiderojmë se AKEP duhet të aplikojë një reduktim të tarifave që minimalisht në kohë respektojnë nivelin e asimetrisë së zbatuar në kohe për operatorin më të ngjashëm me të në pjesë tregu si Albtelecom/Eagle.
- i. Sa më sipër Plus i kërkon AKEP-it, që në përputhje të plotë me nenin 7 të ligjit të mundësojë vijimin e sigurimitin e kushteve të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj të gjithë sipërmarrësve në treg duke siguruar një trajtim të tillë edhe për Plus në marrëdhënie me operatorët e tjerë të konsoliduar në treg. Plus, në alternativë të shfuqizimit të vendimeve të ankimuarra, i kërkon

AKEP të vendosë për pranimin e vlerave maksimale të tarifës për shërbimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësve të tjere sipas vlerave të mëposhtëme:

	1.09.2013	1.04.2014	1.04.2015	1.01.2016	1.01.2017	1.01.2018
Vodafone/AMC	4.57	1.48	1.48	1.48	1.48	1.48
Albtelecom (EM)	4.57	4.00	2.66	1.48	1.48	1.48
Plus	8.85	8.28	5.62	4.00	2.66	1.48

Shënim: Tarifat në lek/minutë pa TVSH

- j. Plus shprehet se nën rregullimin e vendosur nga AKEP, Plusi-t i imponohet pamundësia për të konkurruar në treg e praktikisht detyrohet të dalë nga tregu në një periudhë shumë të shkurtër. Plus shprehet se aplikimi i strategjisë diferencuese të çmimit të thirrjeve brenda rrjetit me jashtë rrjetit shkakton shqetësime për konkurrencën në tregun përkatës si dhe efekte negative për konkurrencën në periudha afatgjata. Diferencimi i çmimeve mund të përdoret si mekanizëm për mbylljen e tregut nga operatorët e mëdhenj për operatorët e vegjël, duke i rrezikuar këta të fundit të dalin nga tregu përkatës. Plus shpjegon se në kushtet kur tregu ka problematika të theksuara për aspekte të konkurrencës dhe rezultojnë që të ketë operatorë me pozicion dominant (vendimi nr. 303 i AK) AKEP duhet të aplikojë një reduktim të tarifave që minimalisht në kohë respektojnë nivelin e asimetrisë së zbatuar në kohe për operatorin më të ngjajshëm me të në pjesë tregu si Albtelecom / Eagle.
- k. Në përfundim Plus, kërkon nga AKEP që të shqyrtojë këtë ankim administrativ dhe të vendosë:
- Shfuqizimin/ndryshimin e Vendimit nr. 2431 date 13.3.2014 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”;
 - Shfuqizimin/ndryshimin e Vendimit nr.2435 date 13.3.2014 “Për miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Plus Communication sh.a”;
 - Shfuqizimin/ndryshimin e Vendimit nr.2432 date 13.3.2014 “Për miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a”;
 - Shfuqizimin/ndryshimin e Vendimit nr.2433 date 13.3.2014 “Për miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albanian Mobile Communication sh.a”;
 - Shfuqizimin/ndryshimin e Vendimit nr.2434 date 13.3.2014 “Për miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albtelecom sh.a”;
 - Pezullimin e zbatimit të akteve administrative si më lart, derisa ky ankim të jetë shqyrtuar plotësisht.

3. AKEP pasi ka shqyrtuar ankimin e Plus vlerëson se:
- a. Në lidhje me pretendimet e Plus për mungesën e bazueshmërisë ligjore të vendimeve e datës 13.03.2014 për tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, AKEP ka dhënë sqarime dhe argumentimin në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik si dhe në dokumentin “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara”, miratuar me VKD nr.2431, datë 13.03.2014 dhe publikuar në faqen e Internetit të AKEP, së bashku me vendimet dhe dokumentin final të MTR.
 - b. Në lidhje me pretendimet e Plus se AKEP nuk ka marrë parasysh rekomandimet e AK në Vendimin nr.303, datë 16.01.2014, për rishikimin e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare, AKEP ka sqaruar në dokumentin final të rishikimit të tarifave të terminimit në rrjetet celulare:
Publikimi i versionit final të dokumentit ‘Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare’ dhe vendimet përkatëse për tarifave të terminimit në rrjetet celulare përbën një rregullim të ndërmarrë nga AKEP pavarësisht nga përfundimet e AK dhe i paralajmëruar nga AKEP që në Analizë tregu 2012, përbën në të njëjtën kohë plotësim të rekomandimit të AK në pikën II.1/a të Vendimit nr.303, datë 16.01.2014, për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare.
 - c. Në lidhje me nivelin e tarifave të terminimit të propozuara nga Plus për t’u përcaktuar nëpërmjet shqyrtimit të këtij ankimi administrativ, si dhe pretendimeve për nivelet e përcaktuara nga AKEP më 13.03.2014, AKEP vlerëson se në përcaktimin e nivelit të tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë ka marrë në konsideratë një sërë faktorësh, dhe nuk gjykon se është e nevojshme që të kryejë një rishikim të tyre në këtë moment kohor. AKEP ka marrë në konsideratë zhvillimet e fundit dhe nivelet e miratuara nga AKEP, cojnë në rritje të asimetrisë në përqindje midis Plus dhe dy operatorëve më të mëdhenj, duke e vendosur atë në pozita më të barabarta konkurruese me operatorët e tjerë. Nivelet e propozuara nga Plus do të conin në një asimetri prej rreth 460% në fazën e parë, cka është një nivel tepër i lartë, në kushtet kur Plus ka pasur tashmë nivel të lartë asimetrie në këto vite.
 - d. Në lidhje me efektet e tarifave të përcaktuara nga AKEP më 13.03.2014 në tregun me pakicë celular dhe konkurrencën midis operatorëve në treg, AKEP është shprehur në dokumentin final se:
AKEP gjykon që të fillojë implementimin e tarifave të terminimit sipas niveleve dhe afateve të dhëna në këtë dokument (Seksioni 4), dhe në Analizën e tregut celular, që është parashikuar të kryhet në 2014, të rishikojë efektet e masave të marra në tregun me pakicë dhe politikën tarifore të operatorëve si dhe nëse ka nevojë për masa të tjera të mundshme rregulluese. Analiza e tregut celular do të trajtojë në mënyrë më të detajuar tregun me pakicë dhe problematikën e tarifave të ulëta brenda grupeve të mbyllura/on-net. Në këtë proces AKEP do të

konsiderojë dhe masat e mundshme të propozuara nga Albtelecom (EM) dhe Plus në komentet e dhëna në këshillim publik të këtij dokumenti.

- e. Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet celulare është përcaktuar nga AKEP jo vetëm në kuadrin e analizave të tregut por edhe në momente kohore dhe procedura të ndryshme (zgjidhje mosmarrëveshje, MTR sipas BULRAIC), ndërkohë që në analizat e tregut të rradhës ka ri-shqyrtuar nivelet e vendosura më parë, duke bërë korrektimet e nevojshme (p.sh. Analiza e tregut 2012). Pra, Analiza e tregut celular do të rishikojë dhe efektet e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet e secilit operator të vendosura më 13.03.2014, përfshirë nevojën për korrektime të mundshme të nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve për krijimin e kushteve sa më të barabarta të konkurrencës midis operatorëve në treg.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Lënien në fuqi të Vendimeve nr. 2431-2435, datë 13.03.2014 të KD të AKEP dhe rrëzimin e ankimit të Plus Communication sh.a. depozituar në AKEP me anë të shkresës nr. 391 Prot., datë 12.4.2014.
2. Tarifat e terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendimet nr.2431-2435, datë 13.03.2014, të Këshillit Drejtues të AKEP, të jenë objekt vlerësimi i Analizës së rradhës së tregut celular;
3. Të njoftohet Plus Communication sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Godina Torre Drin, Kati IX, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

www.akep.al

Fax : + 355 4 2259 106

info@akep.al

